



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.335/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Merita Jashari kandidate për anëtarë të kuvendit të komunës së Vitisë, me numër rendor #29, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e parashtruar nga Merita Jashari kandidate për anëtarë të kuvendit të komunës së Vitisë, ZL.Anr.335/2025, e datës 24.10.2025, me numër rendor #29, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 24.10.2025, PZAP-i përmes postës ka pranuar ankesën ZL.Anr.335/2025 parashtruar nga Merita Jashari kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën së Vitisë, me numër rendor #29, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në të cilën pretendon se nuk është e kënaqur me paraqitjen e rezultatit zyrtar, pasi dyshon se nuk është bërë numërimi korrekt i votave dhe ekziston mundësia e keqpërdorimeve, qoftë të qëllimshme apo të paqëllimshme. Më tej në ankesë pretendon se këto dyshime i bazon në informata të marra nga qytetarët dhe përfaqësuesit e vendvotimeve, sidomos në katër fshatra të Komunës së Vitisë: Sllatinë e Epërme, Ramjan, Drobesh dhe Pozhoran. Andaj, duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe rregullat për ankesa zgjedhore, kërkon që të bëhet rinumërimi i votave për qendrat e votimit në këto fshatra, në mënyrë që të sigurohet transparencë dhe korrektësi e plotë e procesit zgjedhor.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimi në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). KQZ, njofton se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet

nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Andaj në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LP Z, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur asnjë provë që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë. Gjithashtu KQZ njofton PZAP se, me datën 22.10.2025, në orën 20:30, ka përfunduar procesi i administrimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor gjendet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve ankimore, dhe përgjigjes në ankesë, vëren se ankesa është e pabazuar

Paneli pas shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidates për anëtare në Kuvendin e Komunës së Vitisë, nga radhët e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet me prova konkrete se ka pasur parregullsi në gjatë numërimit të votave.

Sipas vlerësimit të Panelit vetëm pretendimi nga ankesa se *“dysjoj se nuk është bërë numërimi korrekt i votave dhe ekziston mundësia e keqpërdorimeve, qoftë të qëllimshme apo të paqëllimshme. Këto dyshime i bazoj në informata të marra nga qytetarët dhe përfaqësuesit e vendvotimeve, sidomos në katër fshatra të Komunës së Vitisë: Sllatinë e Epërme, Ramjan, Drobesh dhe Pozhoran.”* Paneli e vlerëson si të pabazuar për faktin se parashtuesja e ankesës nuk i ka mbështetur pretendimet e saj me prova konkrete, rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, *barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në kuptim, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.*

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore të palës ankuese që mbështetet në informatat e marra nga qytetarët, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, është përcaktuar se *“1.3. liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.”* Prandaj për këtë arsye nuk i mori si ta bazuara, përkatësisht, nuk ia fali besimin këtyre pretendime ankimore në ankesë për të aprovuar ankesën si të bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtuar nga kandidatja për anëtar në kuvend komunal të Vitisë nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është e pabazuar pasi që nuk ka bashkëngjitur prova që dëshmojnë parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mungesave të votave tek kandidatja, mbetet vetëm në suaza të dyshimit të arsyeshëm, por jo të dyshimit të bazuar se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.335/2025 datë 25.10.2025

Kryesues i Panelit
Hajrëz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.